



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

CN.nr.138/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Milena Gjeriq, anëtarë, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit: U. R. Sh.P.K., rr. "...", ... , në P., kundër debitorit: B.-A. Sh.P.K., rr. "...", në S., për shkak të propozimit të kreditorit për përmbarim, përkitazi me konfliktin e kompetencës, në seancën e kolegjit të mbajtur më 18.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Për të gjykuar në këtë çështje juridike - përmbarimore të kreditorit: U. R. Sh.P.K., rr. "...",..., në P., kundër debitorit: B.-A. Sh.P.K., rr. "...", në S., me kompetencë lëndore është Gjykata Themelore Prizren - Dega në Suharekë, të cilës shkresat e lëndës i dërgohen në kompetencë të mëtejme.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore Prizren - Dega në Suharekë, me aktvendimin CP.nr.447/16 të datës 20.01.2023, ka vendosur: I. Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore Prizren - Dega në Suharekë, shpallet jokompetente në pikëpamje lëndore, për të vendosur në këtë çështje juridike. II. Pasi që ky aktvendim të merr formë të prerë, lënda i dërgohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Dhomat e Shkallës së Parë.

Gjykata Komerciale në Prishtinë - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin KPPP.nr.267/23 të datës 22.02.2024 ka vendosur: I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, për të vendosur në çështjen juridike përmbarimore në mes të kreditorit U. R. Sh.P.K., dhe debitorit B.-A. Sh.P.K. II. Për të vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

Në bazë të nenit 25 paragraf 2 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 paragrafi 1, të Ligjit për Gjykatat, Ligji nr.06/L-054 i datës 23.11.2018, konfliktin lidhur me kompetencën midis gjykatave të llojit të ndryshëm e zgjidhë Gjykata Supreme e Kosovës. Në këtë rast Gjykata e Supreme e Kosovës, si gjykatë më e lartë dhe e përbashkët për gjykatat në konflikt ka kompetencë lidhur me zgjidhjen e

konfliktit të kompetencës, ndërsa në bazë të nenit 15 paragraf 3, të LPK-së, përcaktohet se: “ Zgjidhjen e konfliktit për kompetencë territoriale dhe zgjidhjen e konfliktit për kompetencë e cakton trupi gjykues prej tre gjykatësve ”.

Në këtë rast kemi të bëjmë me çështjen përmbartimore midis kreditorit: U. R. Sh.P.K, i cili ka ushtruar propozim, për caktimin e përmbartimit, kundër debitorit: B.-A. Sh.P.K., për shkak të borxhit. Kreditori i ka propozuar gjykatës përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm ku parashihet se debitori i ka borxh propozuesit shumë prej ... €.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës lidhur me konfliktin e kompetencës në mes të Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë dhe Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti i për Çështje Ekonomike, gjeti se kompetente lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike është Gjykata Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, për arsye se:

Me nenin 1 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, përcaktohet se: “ 1. Ky ligj rregullon procedurën përmes së cilës gjykatat dhe përmbartuesit privat përcaktojnë dhe zbatojnë përmbartimin në bazë të dokumenteve përmbartues dhe dokumenteve të besueshme, përveç nëse me ligj të veçantë parashihet ndryshe ”.

Me nenin 12 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatat nr.06/L-054, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr. 22, datë 18 dhjetor 2018, përcaktohet se: “ Gjykatat themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe ” .

Me nenin 13 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe 1.2, të Ligjit Nr. 08/L-015, për Gjykatën Komerciale, përcaktohet se: “ Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre; 1.2. të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbartimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate;...”

Gjykata Supreme vlerëson se në këtë rast me kompetencë lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike-përmbartimore është Gjykata Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, për faktin se palët në këtë çështje përmbartimore pasi që është lejuar përmbartimi, lënda ka qenë në gjykatën themelore, dhe nuk kanë ushtruar ndonjë mjet juridik kundër vendimit për lejimin e përmbartimit, ndërsa kreditori nuk ka kërkuar që lënda të kalojë te përmbartuesi privat ashtu siç është përcaktuar me nenin 397 të LPP, andaj Gjykata Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, mbi bazën e këtyre rrethanave nuk ka mundur të shpallet jokompetente në pikëpamje lëndore por është dashur të vazhdojë në trajtimin e rastit ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e LPP-së. Në rastet kur kemi të bëjmë me zbatimin e përmbartimit sipas propozimit të kreditorit në asnjë rast nuk mund të jetë kompetente Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së parë, sepse e njëjta vendos vetëm lidhur me mjetet juridike që paraqiten ndaj lejimit të përmbartimit dhe në rastin kur palët nuk kanë paraqitur mjet juridik (prapsim apo ankesë), në të gjitha këto raste kompetente për të gjykuar janë gjykatat themelore, varësisht prej kompetencës territoriale.

Nëse ndonjëra nga palët do të paraqiste ndonjë mjet juridik në këtë çështje përmbartimore, atëherë kjo çështje përmbartimore do të ishte në kompetencë të Gjykatës Komerciale, nëse plotësohen

kushtet e përcaktuar sipas Ligjit për Gjykatën Komerciale të cekur më lart, sepse Gjykata Komerciale ka kompetencë lëndore që të vendosë për të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbartimore, ashtu siç është përcaktuar me nenin 13 paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale.

Nga sa u tha më lart, e në kuptim të dispozitës së nenit 25.2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
CN.nr.138/2024 datë 18.03.2024

Kryetar i kolegjit
Rrustem Thaqi